
**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
EUROMEDICA GROUP SHPK**

**AKTI I THEMELIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EUROMEDICA GROUP” SHPK**

Në Tiranë, sot më datë 20.05.2024:

Z. Aleksandër Musta, shtetas shqiptar, lindur në Salari, Tepelenë, më datë 05.04.1956 dhe banues në adresën: “Rruga Hajredin Shtino, Njësia Administrative Nr. 9, Ndërtesa Nr. 30, kod postar 1057, Tiranë, Shqipëri”, mbajtës i pasaportës biometrike me Nr. BE9682006 dhe Nr. personal F60405223F,

Në cilësinë e “ortakut të vetëm themelues” ka vendosur për hartimin e këtij akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklaron se me vullnet të lirë, të plotë, të sinqertë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtraët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, në atë Doganor, Tatimor e Fiskal, të krijoj shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar: **“EUROMEDICA GROUP” sh.p.k.** .

**Neni 1
Emri i Shoqërisë**

- 1.1.** Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“EUROMEDICA GROUP” sh.p.k.** (më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**). Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.
- 1.2.** Shoqëria do të ushtroj veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statuti të Shoqërisë të miratuar nga ortaku dhe në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 1.3.** Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare, të realizuara sipas parashikimeve të ligjeve në fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën.

**Neni 2
Personaliteti Juridik**

- 2.1.** Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
- 2.2.** Shoqëria **“EUROMEDICA GROUP” sh.p.k.**, është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.



Neni 3

Selia

- 3.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: “Rruga Hajredin Shtino, Njësia Administrative Nr. 9, Ndërtesa Nr. 29, kod postar 1057, Tiranë, Shqipëri”.
- 3.2. Ortakët mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër.
- 3.3. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

- 5.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është Tregtimi me pakicë i materialeve mjekësore.
- 5.2. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.
- 5.3. Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizoj drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja, si edhe të hyj në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj.

Neni 6

Kapitali Themeltar i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është 1.000 (njëmijë) Lekë. Kapital i Shoqërisë është i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë si mëposhtë:
Z. Aleksandër Musta, zotëruar i 1 (një) kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 1.000 (njëmijë) Lekë. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlere të tregetueshme.
- 6.2. Kapitali fillestar i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet dhe është totalisht i likujdueshëm dhe i nënshkrueshëm.
- 6.3. Ortaku i vetëm i shoqërisë angazhohet me detyrën për të shtuar volumin e veprimtarisë së shoqërisë, të respektoj detyrimin e sekretit të saj lidhur me tipologjinë e aktivitetit të saj tregtar dhe të mos dëmtoj interesat e shoqërisë.



Neni 7 Transferimi i Kapitalit

- 7.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
 - dh) ortaku ka të drejtë t'jua trashëgoj kuotat e tij bashkëshortes/bashkëshortit dhe fëmijëve.
 - e) në rast se ortaku dëshiron të shes një pjesë të kuotave mund ta bëjë në çdo moment dhe gjithashtu nëse në të ardhmen do të bëhet me ortak pavarësisht % (përqindjes) së kuotave që do të gëzojë në momentin që do të vendosi për të shitur kuotat përkatëse, duhet t'ju jap prioritet fillimisht ortakëve të tjerë nëse do të ketë në të ardhmen dhe nëse ata do të jenë të interesuar në blerjen e tyre.
- Në rast se asnjë nga ortakët nuk shfaq interes ai ka të drejtë të shes kuotat e veta palëve të treta të interesuara.
- 7.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- 7.3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit

- 8.1 Kapitali i shoqërisë mund të rritet në çdo kohë me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 9 Zvogëlimi i Kapitalit

- 9.1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

Neni 10 Organi Vendimarrës

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm në rast se shoqëria është e themeluar nga një ortak i



vetëm. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) të blej, shesë, këmbëj pasuri të patundshme të shoqërisë;
- n) për shpërndarjen e fitimit.

10.2. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

10.3. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku/ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 11 **Administrimi i Shoqërisë**

11.1. Administrator i shoqërisë është **Z. Aleksandër Musta**, mbajtës i pasaportës biometrike me Nr. BE9682006 dhe Nr. personal F60405223F emëruar në këtë detyrë për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data 20.05.2024 deri me date 20.05.2029.

11.2. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

11.3. Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, ortaku i vetëm dhe njëkohësisht përfaqësues ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

11.4. Çdo kontratë apo përfaqësim, do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.



Neni 12 Kompetencat

12.1. Administratori ka te drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësoj Shoqërinë;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentacionit dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumenta përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- dh) kryej regjistrimet dhe dërgoj të dhenat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Regjistrimin e Biznesit;
- e) hap llogari bankare dhe të operoj për llogari të kompanisë pa kufizime;
- f) kërkoj financime pa kufizime për kompaninë nga banka apo institucione të tjera financiare;
- g) raportoij përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- gj) blej dhe të shesë, në emër të Shoqërisë, produkte dhe çdo gjë tjetër si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë territorit të saj;

12.2. Administratori është i detyruar të thërras mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blej nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5 (pesë) përqind të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

12.3. Administratori ka të drejtë të kryej të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

12.4. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizik e juridik, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, Autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu Autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.

12.5. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me palët e treta, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të Shoqërisë.

12.6. Administratori angazhon Shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

12.7. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj palëve të treta kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e Shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në



rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 13

Emërimi dhe Shkarkimi i Administratorit

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme emëron dhe revokon administratorin ose administratorët në fuqi dhe mund të emëroj edhe administratorë të tjerë me detyra të përcaktuara me ligj dhe me autorizim.
- 13.2 Administratori do të ushtroj të gjitha kompetencat e parashikuara me ligj, për administrimin e zakonshëm të Shoqërisë, të përfaqësoj Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët me përjashtim të kompetencave që vetë ligji apo statuti u jep shprehimisht ortakëve. Për çështje të rëndësishme të veçantë administratori konsultohet me ortakun dhe merr masat e përcaktuara, të marra me shumicat e parashikuara me ligj.

Neni 14

Financimi i Shoqërisë

- 14.1 Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkoj nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 14.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.
- 14.3 Ortaku themelues i shoqërisë, mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortaku ka pasur përpara se ajo të krijohet.

Neni 15

Viti Financiar dhe Fitimet e Shoqërisë

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.
- 15.2 Fitimet e Shoqërisë i takojnë ortakut të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre duke përcaktuar edhe modalitetet për këtë procedurë.

Neni 16

Kontrolli Kontabël

- 16.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortaku i Shoqërisë do të emëroj një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.



Neni 17
Bilanci Vjetor dhe Rezervat

- 17.1 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që ortaku i Shoqërisë të vendosi mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 17.2 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventarët, raportet e Administratorit dhe Ekspertit Kontabël miratohen nga ortaku i Shoqërisë. Administratori i paraqet Ortaku të Shoqërisë për miratim, raportin mbi administrimin e Shoqërisë si dhe pasqyrat financiare vjetore.
- 17.3 Ortaku i Shoqërisë vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 17.4 Ortaku i Shoqërisë në çdo moment mund të vendosi krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

Neni 18
Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

- 18.1 Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 19
Njoftimet

- 19.1. Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 19.2. Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 19.3. Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do t’i drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

Neni 20
Ligji i Zbatueshëm

- 20.1. Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të Statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.



- 20.2. Shoqëria do të zhvilloj veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e këtij Akti Themelimi, Statuti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 20.3. Për të gjitha ato çështje që nuk janë parashikuar në këtë dokument, do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 9904 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 21

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 21.1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shoqërisë/Ortakëve dhe/ose ortakëve të saj, trashëgimtarëve, Administratorit, lidhur me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve të interesuara.
- 21.2. Në rast se nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë juridiksioni i Republikës së Shqipërisë, në zbatimin të ligjeve shqiptare.

Neni 22

Regjistrimi

- 22.1. Ky Akt Themelimi i Shoqërisë do të hyj në fuqi pas regjistrimit në regjistrat përkatës, nga organet shtetërore kompetente.


Neni 23

Dispozita Përfundimtare

- 23.1. Ky akt themelimi u redaktua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike.
- 23.2. Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortaku themelues i vetëm i shoqërisë tregtare “**EUROMEDICA GROUP**” sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

ORTAKU I SHOQËRISË “EUROMEDICA GROUP” sh.p.k.

Aleksandër Musta


(emër, mbiemër, firmë)